

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Muhamet Rexha dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A. B., E.B., Z. Sh., M.1B.1, B. B. dhe T1. B1., të gjithë nga ..., të cilët i përfaqëson T. B. nga ..., dhe paditësit M.2 B.2, I1. B.1., I.2 B.2., N.1 B.1 dhe H. B., të gjithë nga ..., të cilët i përfaqëson e autorizuara M. Ç., avokate nga ..., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për shkak të anulimit të kontratës mbi dhuratën dhe dorëzimin në posedim të paluajtshmerisë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësve avokates M. Ç., nga ..., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2926/2013 datë 20.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.09 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të autorizuarës së paditësve, av. M. Ç. nga P..., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2926/2013 datë 20.02.2017.

A r s y e t i m i

Me pjesën I. të dispozitivit, të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2926/2013 datë 20.02.2017, refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarës së paditësve M.2 B.2, I.B., dhe I.2 B.2, N. B. dhe H. B., të gjithë nga ..., dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.394/2007 datë 10.07.2013, në pikën I. të dispozitivit, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësve M.2 B.2, I.1 B.1, I.2 B.2, N.1 B.1, dhe H. B., të gjithë nga ..., përmes të cilës kanë kërkuar që të vërtetohet se në drejtim të tyre është nul kontrata mbi dhuratën e patundshmërisë e lidhur ndërmjet N. B. si dhuratëdhënës dhe Komunës

së Prizrenit si dhuratëmarrës, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.1534/60 datë 12.12.1960, dhe të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit që paditësve M.2, I., N., I.2 B.2, t'ia dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë 1/3 e patundshmërive me numër të ngastrës ..., në sipërfaqe prej 55,79 ari, dhe ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 4,01 ari, apo gjithsejtë në sipërfaqe prej 59,80 ari, sipas listës poseduese nr..., ZK Prizren, ndërsa paditësit H. B., t'ia dorëzojë 1/3 të patundshmërive të cekura më lartë, dhe t'ia lejojë paditësit që pranë shërbimit për kadastrë dhe gjeodezi në komunën e Prizrenit të regjistrohen si bashkëpronar në lëndët e patundshmërive, të paguajë e paditura shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, si tërësisht e pabazuar. Me pjesën II. të dispozitivit, ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale. Në pjesën III. të dispozitivit, ka vendosur që padinë e paditësve A. B. , E. B., Z. B., M.1 B.1, B. B. dhe T.1 B.1., të gjithë nga ..., ta konsiderojë të tërhequr.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e autorizuar e paditësve M.2. B.2., I.1 B.1, I.2. B.2., N. B. dhe H. B., të gjithë nga ..., avokatja M. Ç., nga ..., ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të aprovet kërkësëpadia e paditësve apo aktgjykimi i goditur të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Nga shkresat e lëndës del se paditësit në padinë e parashtruar, si trashëgimtar ligjor të të ndjerëve K. B., dhe M.3. B.3, kanë kërkuar që të vërtetohet se është nule kontrata mbi dhurimin e paluajtshmerisë e lidhur ndërmjet N.2. B.2, si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit si dhuratëmarrës, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr..., datë ..., për shkak se siç thonë ata, kontratën e dhurimit paraardhësi i tyre kishte lidhur nën presionin e organeve policore të atëhershme, nga të cilat ishin maltretuar fizikisht dhe psikikisht dhe se kontratën e kishin lidhur kundër vullnetit tij, në kundërshtim me nenin 103 të LMD-së, prandaj kontrata, si e tillë, nuk prodhon efekt juridik. Po ashtu kanë kërkuar të detyrohet e paditura që paditësve si trashëgimtar ligjor pas vdekjes së paraardhësve juridike, t'ia dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmërinë me numër të ngastrës kadastrale ..., në sipërfaqe prej 55,79 ari, dhe ngastrën kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 4,01 ha, apo gjithsejtë sipërfaqen prej 59,80 ari, sipas fletës poseduese nr..., ZK ..., ndërsa paditësit H. B., t'ia dorëzojë 1/3 e paluajtshëmërive

të cekur më lart, si dhe t'ia lejoj paditësit që pranë shërbimit për kadastër dhe gjeodezi në Komunën e Prizrenit të regjistrohen si bashkëpronar në lëndët e patundshmërive.

Gjykata e shkallës së parë, me administrimin e provave, lidhur me mënyrën e vendosjes si në pikën I. të dispozitivit ka gjetur se paditësit me asnjë provë të vetme nuk e kanë vërtetuar faktin se paraardhësit e tyre M.3. B.3, dhe K. B., kanë qenë bashkëpronar të ngastrave kontestuese. Sipas kontratës mbi ndarjen e bashkësisë familjare Leg.nr..., datë ..., e lidhur në mes tani të ndjerëve N.2 B2., M.3 B.3., dhe K. B., ka rezultuar se ngastrat kontestuese kanë qenë pjesë e pasurisë së përbashkët e tyre, ndërsa kjo kontratë është lidhur më herët se kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë Leg.nr..., datë ... Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarës së paditësve se paraardhësi i paditësve kanë qenë bashkëpronar me 1/3 , e patundshmërive kontestuese, kjo për faktin se nga ekspertiza e ekspertes së gjeodezisë dhe certifikata nr..., nr..., e datës ..., e lëshuar nga Zyra komunale e kadastrit në ..., është vërtetuar se ngastrat nr..., dhe ..., prej matjes detaje të vitit 1953 , e cila ka hy në fuqi në vitin 1957, janë evidentuar në pronësi të N.2 (I) B.2., nga ..., deri në vitin 1960, i cili është paraardhës i paditësve, kurse nga viti 1960 ngastrat e lartcekura pësojnë ndryshime në bazë të kontratës mbi dhurimin Leg.nr..., datë ..., të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe kalojnë në pronësi të P.Sh. KK Prizren, fleta poseduese e vjetër nr..., ZK ...

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë e drejta për të kërkuar anulimin e kontratës kontestuese pushon me skadimin e afatit prej 3 vitesh nga dita e lidhjes së kontratës në bazë të dispozitave të LMD-së, i cili afat është prekluziv, ndërsa në rastin konkret kontrata mbi dhurimin Leg.nr.1534/60, anulimi i së cilës kërkohet është lidhur me datën 27.12.1960, kurse padia e paditësve për anulimin e kësaj kontrate është bërë me datën 31.05.2007, fillimisht nga paditësit A. B., etj., ndërsa paditësit tjerë janë kyçur në lëndë me datën 01.06.2009, që bie diku pas 47 vitesh, përkatësisht 49 vitesh, që do të thotë pas kalimit të afatit ligjor prekluziv prej 3 vitesh.

Si në pikën III. të dispozitivit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i autorizuari i paditësve A., E., Z., M., B. dhe T. B., nuk kanë prezantuar në shqyrtimin kryesor të datës 18.06.2013, përkundër faktit se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, por mungesën nuk e kanë arsyetuar, dhe mbi këtë bazë padinë e paditësve në mbështetje të dispozitës së nenit 111 dhe 117 të LMD-së, e lidhur me nenin 143 të LPK, ka konsideruar të tërhequr.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat ajo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimeve të tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante për vendosjen e drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke shtuar se, për faktin e vërtetuar se kontrata mbi dhurimin e patundshmërisë e cila është lidhur ndërmjet N.3 B.3 si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit si dhuratëmarrëse e legalizuar në Gjykatën Komonale në Prizren Leg.nr..., datë ..., në rastin konkret nuk mund të zbatohen dispozitat e LMD-së, i cili ka hy në fuqi më 01.10.1978, sepse , sipas nenit 1106 të këtij ligji, dispozita e tij nuk do të zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve të sajura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por do të zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës civile të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës, e cila është objekt shqyrtimi në këtë kontest, por të dy gjykatat , në esencë , i kanë zbatuar drejtë këto rregulla , kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerëson si të pabazuara thëniet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ulët e kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, nga se , siç ceket në revizion, paditësit kanë kërkuar anulimin e kontratës e cila është absolutisht nule sipas nenit 103 të LMD, nga se , siç u tha më sipër këto dispozita nuk mund të zbatohen në rastin konkret për faktin se ky ligj nuk ka ekzistuar në kohën e lidhjes së kësaj kontrate dhe se në revizion nuk është cekur konkretisht se me kontratën nule cilat rregulla të rendit juridik , me cilën dispozitë imperativë apo morale shoqërore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës është lidhur kontrata mbi dhuratën, e cila është objekt shqyrtimi në këtë kontest. Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes nuk kanë ekzistuar rrethanat që kanë ndikuar që ajo të jetë e lidhur në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperativë dhe moralin shoqëror, në kohën e lidhjes së kontratës, gjykatat e instancës më të ulët, sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit, kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e

paditësve është e pabazuar. Vlefshmëria juridike e kontratës vlerësohet sipas dispozitave juridike të cilat kanë qenë në fuqi në momentin e lidhjes së kontratës e jo dispozitat e mëvonshme, me përjashtim të rasteve ku me ligj të veçantë është caktuar ndryshe, por LMD nuk përmban dispozita të tilla.

Nuk ekziston asnjë qëndrim juridik i ndonjë gjykate më të lartë në Kosovë sipas të cilit në mënyrë të paligjshme kontratat mbi dhuratën të lidhura mes pronarëve individual të tokave bujqësore dhe Kuvendit Komunal të jenë të vlerësuara absolutisht nule, por gjykatat vlerësimin juridik e vlerësojnë duke pas parasysh të gjitha rrethanat e çdo rasti konkret.

Përndryshe, për arsyet e dhëna nga kjo Gjykatë nga aspekti i zbatimit të gabuar të së drejtës materiale aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë të ligjshme dhe çdo pretendim në revizion mbi këtë bazë është i pa pranueshëm.

Së këndejmi, pretendimet në revizion se aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për faktin se në revizion përshkruhet konstatimi faktik dhe qëndrimi juridik i të dy gjykatave, dhe nuk janë saktësuar në kuptim të ligjit se ku konsistojnë shkeljet e pretenduara, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin vetëm në pjesët e goditura konform nenit 215 të LPK-së.

Mbi bazë të asaj që u tha më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.191/2017 datë 19.09.2017

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani